

## Studime në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn në Universitetin Politeknik (UPT)

Janë mbi 50 vite që UPT ofron studime në arkitekturë duke udhëhequr formimin e brezave të profesionistëve më të mirë në vend. Veprat dhe studimet më të rëndësishme arkitektonike e urbane në vend janë ideuar e realizuar nga specialistët e diplomuar në UPT.



### Të studiosh në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)

Vizioni i FAU është që të ofrojë standarde lider në edukimin e projektuesve të rinj në fushat e arkitekturës dhe urbanistikës, nëpërmjet shfrytëzimit të kapaciteteve dhe përvojës së tij shumëvjeçare, për të orientuar studentët në fitimin e njohurive dhe të aftësive të nevojshme për një karrierë kreative dhe të suksesshme.

Misioni i FAU është të zhvillojë një kurrikulum për të edukuar dhe mësuar arkitektët dhe projektuesit e ardhshëm si profesionistë novatorë, krijues, të ndjeshëm ndaj kulturës dhe të përgjegjshëm ndaj ambientit me aftësi të larta mendimi dhe me njohuri bashkëkohore të teknologjive, që të mund të ndajnë dhe të aplikojnë njohuritë ndërmjet tyre dhe me disiplina të tjera, si dhe të jenë të hapur ndaj mundësive të reja të bashkëpunimit në procesin e mësimit dhe të praktikës profesionale.

Misioni i FAU bazohet në kultivimin e dijes dhe percjelljen e saj nëpërmjet veprimtarisë kërkimore e shkencore. Ky është një mision publik dhe synon edukimin e brezave të rinj të arkitektëve dhe urbanistëve me orientim shkencor dhe me etikë të lartë profesionale dhe qytetare

### Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn (BAID)

- Programi mundëson formimin profesional në nivelin bachelor, duke formuar specialistë të mirëfilltë në fushat e arkitekturës së interierit dhe të dizajnit. Ai synon arritjen e niveleve të larta profesionale në zgjidhjen e problemeve të arkitekturës së interierit dhe dizajnit. Gjatë studimit, do të merren njohuri, duke synuar përvetësimin e metodologjive të projektimit dhe të zbatimit të projekteve. Njohuritë teorike do të ndërthuren me aspekte praktike që lidhen me zhvillimet teknologjike, me kërkesat e tregut dhe normat e kodet

e projektimit e zbatimit.

- Programi synon të zhvillojë vlerat e respektit reciprok, bashkëpunimit dhe komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, shërbimit të komunitetit dhe përgjegjësitë ndaj zhvillimit të vendit. Ai kontribuon në rritjen e standardeve të jetesës në ndërtesa shoqërore e private duke tentuar të përgatisë profesionistë për sfidat e reja të zhvillimit të vendit dhe të shoqërisë.

### Programi i studimit BAID synon që studenti:

-te fitojë njohuri në lëndët e formimit të përgjithshëm, duke qenë në gjendje t'i përdorë këto njohuri në funksion të formimit profesional.

-te fitojë njohuri në bazat e grafikës dhe vizatimit, ergonomi, kompozim të hapësirës, projektim interieri, dizajn, materiale ndërtimi, impiantistikë, etj. Përvetësimi i këtyre njohurive do të realizohet lidhur ngushtë me historinë dhe teorinë e artit, arkitekturës, interierit dhe dizajnit.

-të përvetësoje rregulla dhe parime mbi projektimin ambiental, rinovimin, konservimin dhe restaurimin, vlerësimin ekonomik apo organizimin e punimeve.

-të aftësohet në komunikimin verbal dhe grafik, të organizojë e drejtojë ideimin, projektimin, realizimin e punimeve apo prodhimin në koordinim me specialistë të tjerë.

Mundësitë e punësimit:

-Riformulim dhe arredim me trajtim të specializuar i ambienteve të interierit, publike e private

-Modelim e arredim i pavijoneve në ekspozita, panairë, etj.-

Zbatim i projekteve të arkitekturës së interierit

-Projektim i objekteve të arredimit dhe objekteve të përdorimit në masë

-Prodhim i objekteve të arredimit dhe objekteve të përdorimit në masë

- Përpunim grafik pranë studiove të arkitekturës apo dizajnit

-Konceptim dhe realizim grafik reklamash, faqosje, poster, etj.

Të dhëna mbi programin:

- Kohëzgjatja normale 3 vite / 6 semestra me kohë të plotë

- 180 kredite ECTS

- 35 kuota për vitin akademik 2024-2025

-Në përfundim të programit studenti mund të ndjekë studime të thelluara në programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional apo Master i Shkencave (në UPT apo në IAL të tjera vendase dhe të huaja)